



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-007

Prishtinë, më 8 mars 2011, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 8 MARS 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Sasha Rashiç dhe Rasim Demiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe
NDI: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 3 dhe 4 mars 2011,
2. Shqyrtimi i Propozim – Vendimit për krijimin e komisioneve parlamentare dhe emërimin e kryetarëve, të nënkryetarëve dhe të anëtarëve të komisioneve,
3. Shqyrtimi i Propozim – Vendimit për ndarjen e përkohshme të mjeteve për partitë politike, për periudhën janar – mars 2011.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 3 dhe 4 mars 2011

Kryesia miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve, të mbajtura më 3 dhe 4 mars 2011.

2. Shqyrtimi i Propozim – Vendimit për krijimin e komisioneve parlamentare dhe emërimin e kryetarëve, të nënkryetarëve dhe të anëtarëve të komisioneve

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë pikë, vendosi që të gjitha grupet parlamentare deri me datën 9 mars 2011, t'i sjellin në Administratë të Kuvendit emrat për kryesuesit, zëvendëskryesuesit dhe anëtarët e komisioneve, që në seancën plenare që do të mbahet më 10 mars 2011, të jenë të gatshme për miratim.

3. Shqyrtimi i Propozim – Vendimit për ndarjen e përkohshme të mjeteve për partitë politike, për periudhën janar – mars 2011.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje mori, këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE PËR FINANCIMIN E SUBJEKTEVE POLITIKE TË
PËRFAQËSUARA NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE TË GRUPEVE
PARLAMENTARE PËR 3/12 e vitit 2010

I.

Në kuadër të buxhetit të miratuar për Kuvendin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, mjetet financiare nga kategoria - Subvencione dhe transfere paraqesin mjetet e ndara për financimin e subjekteve politike, të përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në shumën prej 1,901,783.00€. Meqë buxheti i vitit 2011 ende nuk është miratuar, në pajtim me nenin 24. 1. a dhe 24.2 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, mjetet u ndahen subjekteve politike sipas kriterit të vendeve të fituara në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, datë 12 dhjetor 2010, në shumën prej 452,862.96 €, sipas Shtojcës nr. 1., vetëm për tre muajt e parë të vitit 2011.

II.

Për financimin e grupeve parlamentare ndahen mjetet prej 5% nga mjetet e ndara sipas pikës I.

Këto mjetet (5%) u ndahen vetëm grupeve parlamentare që përbëhen nga subjektet politike, nga buxheti i paraparë për subjektin e përfaqësuar në grupin parlamentar. Në rast të përbërjes së një grupi parlamentar nga dy ose më shumë parti, mjetet ndahen në proporcion sipas përfaqësimit të tyre në grupin parlamentar.

Mjetet u alokohen grupeve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në shumën prej 22.384 €, sipas Shtojcës nr. 2.

Të ndryshme

Nënkryetari i Kuvendit, **Petar Miletqi**, paraqiti pakënaqësinë e deputetëve të komunitetit serb lidhur me debatin që ishte zhvilluar në seancën e 7 marsit 2011, për dialogun Kosovë – Serbi. Ai tha se deputetët e komunitetit serb janë ndier të ofenduar nga disa diskutime që janë zhvilluar në këtë seancë.

Nënkryetari i Kuvendit, **Sabri Hamiti**, propozoi që Kuvendi ta formojë një delegacion të përhershëm për ta përfaqësuar Kuvendin e Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 10:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për çështje plenare dhe procedurale.